



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUKËS

NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Data __.__.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS

“Hartim Projekti per Rikonstruksion I shkolles “Lidhja e Prizerenit”, Rikonstruksion I shkolles se mesme “Elmaz Ademi”, Bardhoc dhe Rikonstruksion I godines Bashkia Kukes”

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 39715200-9

VLERA E FONDIT LIMIT

7,354,570 (shtate milion e treqind e pesedhjetë e kater mije e peseqind e shtatedhjetë)

Leke pa Tvsh

Argumentimi i fondit limit: Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (b) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim”, çmimet i ka bazuar te studimi i tregut bazuar kjo në mesataren e çmimeve të marra nga studimi që ka kryer komisioni i llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike (KLLFLST). Gjithashtu (KLLFLST) është bazuar edhe në VKM 354 datë 15.01.2016 dhe ne punime te ngjashme (Dokumentuar me relacionin shpjegues të KLLFLST nr. 2865//3 prot, datë 24.05.2024.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor ”Bashkia Kukes” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1.1 Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar), me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar) me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”,Neni 82 si dhe nëVKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Këto kritere janë vendosur për të vërtetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte.Gjithashtu këto kritere janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjësinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

c. Formulari i ofertës sipas shtojcës 1;

d.Lista e çmimeve të artikujvesipas zërave të preventivi sipas shtojcës 2;

Shenim:Dokumentat e kërkuara më sipër në pikën d dhe c do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç” (sipas Shtojcës 1 dhe 2 te DST).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), si dhe nenit.....

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 8 dhe 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 14, pika 2, dhe 77, pika 1/a dhe 2, të LPP (i ndryshuar) me ligjin nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 "Per prokurimin publik"; nenin 39, pika 6/b, dhe nenin 88, Pika 4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

Ky kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të kontratës.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, **Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr. 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*; si dhe nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore). Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara me poshte, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), dhe nenit 41, pika 3(ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvojave të duhura, që janë në perpjesetim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

2.3.1 Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:

2. PROJEKTUES ARKITEKT

a) Projektim arkitekturor për objekte banimi-objekte industriale-objekte turistike;

b-1) Objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara;

b-2) Qendra tregtare; objekte social-kulturore; objekte kulturi; objekte arsimore;

b-3) Objekte spitalore; terminalët në infrastrukturë; vepra arti në infrastrukturë;

c- Projektim interiere;

d- Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a) Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

b) 1. Objekte civile - industriale - turistike mbi 5 kate – 2. objekte me skelet metalik.

d) Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike;

4. PROJEKTUES INSTALATOR

a) Projektim të instalimeve hidro-termosanitare;

- b) Projektim te instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme;
- c) Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile e industriale;
- d) Projektim te sistemeve komplekse te telekomunikacionit;
- f) Projektim te sistemeve kundra zjarrit.;
- g) Projektim te sistemeve te monitorimit dhe automatizimit ne industri dhe ndertesa;
- i) Projektimi i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndricimit te objekteve te medha sportive, porteve aeroporteve, etj.;
- j) Projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit te zjarrit, etj., per objektet civile dhe industriale.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

- b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

6. PROJEKTUES GJEODET

- a) Rilevime inxhinierike
- b) Rilevime inxhinierike kadastrale
- c) Sistemet GIS
- d) Bazamente gjeodezike
- e) Projektim fotogrametrik dhe hartografik

7. STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

- a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.
- d) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët

8.PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGISË ELEKTRIKE

- e) Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

10. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

- a) Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.

b) Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.

e) Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkrifta me mundësi lëngëzimi.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar) si dhe në Vendim nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim".

Kategoria e kërkuar	Pikat e kategorisë	Përshkrimi për kategoritë
2.Projektues arkitekt	2/a – projektim arkitekturor per objekte banimi;objekte industriale;objekte turistike 2/b-1 – objekte sportive te mbuluara ose pjeserisht te mbuluar 2/b-2 – qendra tregtare;objekte social-kulturore;objekte kulti;objekte arsimore 2/c – projektim interieri 2/d – projektim peisazhi; sistemim siperfaqe te gjelbra, lulishte e parqe	Referuar Detyrave të Projektimit, në projekt do të parashikohen punime ne objekte arsimore dhe institucione , do te projektohen ambientet sportive te shkollave, interieri I brendshem I godinave dhe sistemimi I oborreve te jashtem.
3. Projektues Konstruktore	3/a- projektim objekte civil-industrial-turistike prej murature e skelet	Duke ju referuar Detyrës të Projektimit, parashikohen punimet per projektimin e godinave 2-4 kat dhe vleresimi I kapaciteteve mbajtes te tyre ne gjendjen ekzistuese.

	<i>beton arme deri 5 kate</i> <i>3/b-2 objekte me skelet metalik</i> <i>3/d- vleresim I kapacitetit mbajtes dhe perforcim I strukturave mbajtese prej beton-arme , murature dhe metalike</i>	
--	---	--

<i>4. Projektues instalator</i>	<i>4/a-Projektim te instalimeve hidro-termosanitare;</i> <i>4/b- Projektim te instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme;</i> <i>4/c- Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile e industriale;</i> <i>4/d- Projektim te sistemeve komplekse te telekomunikacionit;</i> <i>4/f- Projektim te sistemeve kundra zjarrit.;</i> <i>4/g- Projektim te sistemeve te monitorimit dhe automatizimit ne industri dhe ndertesa;</i> <i>4/i- Projektimi i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndricimit te objekteve te medha sportive, porteve aeroporteve, etj.;</i> <i>4/j- Projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit te zjarrit, etj., per objektet civile dhe industriale.</i>	Duke ju referuar Detyrave të Projektimit do të parashikohen punime per instalimin e sistemeve hidro-sanitare, te kondicionimit, elektrike , te monitorimit me kamera dhe komunikimit, MNZ etj.
--	---	---

5. Projektues vepra hidraulike	5/b- projektim furnizimi me uje; kolektore shkarkimi	Referuar detyrave të projektimit parashikohet punime për ndërtimin e sistemit të furnizimit me uje dhe të trajtimit të ujerave të ndotura.
6. Projektues gjeodet	4/a- Rilevime inxhinierike 4/b- Rilevime inxhinierike kadastrale 4/c- Sistemet GIS 4/d- Bazamente gjeodezike 4/e- Projektim fotogrametrik dhe hartografik	Referuar detyrës së projektimit do të ketë rilevime inxhinierike për objektet dhe punime gjeodezike.
7.Studim Gjeologo- Inxhinierik Hidrologjik	7/a- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate. 7/b- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët	Studim dhe vlerësim i gjeologjisë së truallit ku ndodhet objekti ekzistues dhe raportet për masat që duhet të meren në bazë të studimit.
8. Projektimi i impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike	8/e- Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm	Detyrat e projektimit parashikojnë punime të ndricimit të ndertesave.
10. Studime të sizmologjisë inxhinierike	10/a- Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve. 10/b- Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen	Dote kryhen studimet lidhur me gjendjen dhe rrezikun sizmik në keto objekte.

	<i>objektet civile, sociale e kulturore.</i> <i>10/e- Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkrifta me mundësi lëngëzimi.</i>	
--	---	--

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik stafin si më poshtë dhe të jenë të përfshirë në listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar:

- 1 (nje) Arkitekt;
- 1(nje) Inxhinier Ndertimi (profili Strukturist);
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet/Markshajder
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik;
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik (HVAC);
- 1 (nje) Inxhinier Mjediti
- 1 (nje) Inxhinier Elektronik

Per stafin e mesiper Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë .

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues për stafin teknik do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Përmiratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës:

Argumentimi.

Personeli i mësipërme kërkohet në bazë të zërthimit të nevojave për hartimin e projektit.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete si staf mbështetës si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Elektronik
- 1 (nje) Inxhinierë Ndërtimi;
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Markshajder
- 1 (një) Ekspert Zjarrëfikës;
- 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratrat individuale te punes (të vlefshme), Diplomë.

Këto kriterë përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete nje ekspert per Auditimin Energjitik te certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne ndertesa;

Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratrat e punes mes dy paleve, Diplomë, Certifikate.

Këto kriterë përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatori ekonomik te garantoje perputhshmerine me rregulloret kombetare te efikasitetit energjistik, optimizim i kostove dhe qendrueshmerine mjedisore .

2.3.6 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 14 (katërmbëdhjetë) punonjës për muajin fundit të deklaruar, të vërtetuar me:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar.

b) Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per per periudhen e fundit te deklaruar.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur dhe te paraqese Certifikatat te pershtatshme **ose ekuivalentet e tyre** per objektin e prokurimit si me poshte:

- a) ISO 9001: 2015, Per menaxhimin e cilesise;
- b) ISO 14001:2015, Per menaxhimin mjedisor
- c) ISO 45001: 2015 Per sigurine ne pune
- d) ISO 50001:2018, Per menaxhimin e Energjise

Shënim: Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), dhe nenit 44 pika 1 dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik(i ndryshuar),

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

“Në zbatim të ligjit Nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar, Operatorët ekonomikë të shpallur fitues për nënshkrimin e një kontrate publike në përfundim të procedurës, duhet të kenë:

Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin.Platformen Qendrore të Faturave.

Kopje të Çertifikatës elektronike per Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen software-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike.”

Oferta ekonomike duhet të jetë në perputhje me:

Kandidati ofertues në përlogaritjen e ofertës ekonomike duhet ti referohet në

Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit

të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.

Konsulentët mund të bashkohen me njëri-tjetrin, në formën e një bashkimi konsulentësh ose me një marrëveshje nënkonsulence, për plotësimin e fushave të tyre përkatëse të ekspertizës për fuqizimin e anës teknike të propozimeve të tyre dhe për vënien në dispozicion të një ekipi më të madh ekspertësh, për të ofruar propozime më të mira dhe, në disa raste, për të ofruar çmime më të ulëta. Një bashkim i tillë mund të krijohet për një afat të gjatë, pavarësisht nga detyra specifike ose mund të krijohet edhe për një detyrë të veçantë. Në çdo rast, ky bashkim duhet të dokumentohet me një kontratë të lidhur. Në rastin e bashkimit të konsulentëve secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për kualifikim sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit në nenin 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Theksojme se Specifikimet teknike, përlogaritja e vlerës së fondit limit detyra e projektimit janë hartuar nga Grupi i punës për përlogaritjen e fondit limit si dhe Drejtoria e PKZHT-se (Urbanistika)

Dokumentacioni është pjesë e dosjes ligjore të prokurimit.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.